



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Junikut

Opština Junik – Municipality of Junik




KONTRATA

Titulli i tenderit: **Rregullimi i hapësirave rekreative gjelbëruese për rreth shtratit të lumit Erenik / Punë shtesë**

Numri i prokurimit: 636-20-7798-5-3-5

Numri i brendshëm: 636-19-025-521/5

Data: 08.12.2020



Komuna e Junikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), e përfaqësuar nga U.D. Zyrtaria Përgjegjëse e Prokurimit, Florinda Kukalaj në njërën anë, dhe

Grupi i Operatorëve Ekonomik Berisha Com sh.p.k; Q- Shala sh.p.k (në vazhdim "Kontraktuesi"), me numër të regjistrimit të biznesit dhe me numër fiskal 811359274, me adresë 50 000, Gjakovë, me numër kontaktues: 044-179-573 dhe email: berisha_com@hotmail.com e përfaqësuar nga Sahit Berisha në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një ankes-kontratë publike për punët e shënuara me poshtë:

Numri i prokurimit	636	2	0	7	7	9	8	5	3	5
Numri i brendshëm	636		1	9	0	2	5	5	2	1/5

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë **Rregullimi i hapësirave rekreative gjelbëruese për rreth shtratit të lumit Erenik / Punë shtesë**

1.1 Kontrata hynë në fuqi me 08.12.2020 dhe përfundon me 08.01.2021.

1.2 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.3 Vendi i kryerjes së punëve do të jetë hapësira rreth shtratit të Lumit Erenik.

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 1,623.68 €; Njëmijë e gjashtëqind e njëzetë e tri euro e gjashtëdhjetë e tetëcent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Pejë- Dega në Deçan në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Grupin e Operatorëve Ekonomik: Për Autoritetin Kontraktues- Komuna Junik
Berisha Com sh.p.k; Q- Shala sh.p.k

Emri:	Sahit Berisha	Emri:	Florinda Kukalaj
Pozita:	Drejtor	Pozita:	U.D. Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.12.2020	Data:	08.12.2020
Vula:		Vula:	



Paramasa dhe parallogaria

Regullimi i hapësirave rekreative gjelbëruese rreth lumit Erenik					
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma totale
1	Furnizimi me material mbushës rrethor, pergaditja, rrafshimi dhe planifikimi i bazës e cila pastaj do të renovohen pjesët e demtuara të shtratis të lumit.	m³	55.00	0.00	0.00
2	Germimi i dheut për mbjelljen e pemëve. Dheu duhet të bartet deri në deponi.	m³	100.00	0.00	0.00
3	Furnizimi, transporti i homosit për mbjelljen e pemëve.	m³	100.00	0.00	0.00
4	Ngarkimi, bartja dhe hudhja në deponi e mbeturinave dhe materialeve të mbetura në shtratin e lumit.	m³	550.00	0.00	0.00
5	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e fidaneve të drunjëve të ndryshëm nga tregu vendor: bliri i bute, pishat.	copë	100.00	0.00	0.00
11	Hapja e themeleve me dimensione b*d*th=(12.0*3.15*2.0) m, në shtratin e lumit për ndertimin e pragjeve si dhe të bëhet ngjeshja e tabanit të themeleve.	m³	226.80	0.00	0.00
12	Furnizimi dhe betonimi i shtresës mbrojtëse me trashësi t=5cm me beton të markës MB 20	m³	3.84	0.00	0.00
13	Furnizimi, transporti dhe armimi i pragjeve të betonit sipas projektit.	kg	3,850.00	0.00	0.00
14	Kallupimi, furnizimi dhe betonimi i pragjeve me beton të markës MB-40 sipas projektit.	m³	24.98	65.00	1,623.6
15	Furnizimi sjellja dhe punimi i kaskadave në pjesët e demtuara të shtratis ekistues. Kaskadat punohen duke vendosur guret në shtresën e betonit dhe lyerjen e fugave me llaq çimentoje. Trashësia mesatare është 25 cm.	m²	150.00	0.00	0.00
15	Furnizimi sjellja dhe punimi i trotuarit me kocka betoni me trashësi 6 cm.	m²	30.00	0.00	
16	Furnizimi, transporti dhe montimi i shportave për mbeturina sipas detajit të dhënë në Projekt.	copë	10.00	0.00	0.00
17	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulëseve nga druri sipas detajit të dhënë në Projekt. Në llogari duhet të përfshihet edhe krijimi i bazës nga betoni dhe ulëset duhet të inkastrohen në beton.	copë	5.00	0.00	0.00
18	Furnizimi, transporti dhe montimi i dërrasave në urën për këmbësorë sipas detalit në projekt. Shtangimi duhet të bëhet me bulona dhe dado me d=1.0cm, paraprakisht bëhet shpimi i vrimës për vendosjen e bulonave.	m²	20.00	0.00	0.00
TOTALI					1,623.6